



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr: 1678 Prot

Tiranë, më 15.06.2023

NJOFTIM PËR PARAQITJE OFERTASH

Në bazë të Urdhërit me Nr. 116 Prot., datë 14.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, për zhvillimin e olimpiadës ndërkombëtare ballkanike të matematikës për të rinj JBMO Albania 2023, shpallim njoftimin për të paraqitur oferta për objektin “Akomodimi në hotel (fjetje + 3 vakte ushqim) për pjesëmarrësit në olimpiadën ballkanike të matematikës për të rinj JBMO Albania 2023”, i ndarë në lote, me fond limit 3,300,825 (Tremilion e treqind mijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH;

Loti I : 640.160 lekë pa TVSH.

Loti II : 2.660.665 lekë pa TVSH

Jeni të lutur të paraqisni ofertën Tuaj për këto objekte brenda datës 19.06.2023, ora 10.00, me të dhëna si më poshtë :

Për lotin I ”Akomodim (fjetje dhe ushqim-3 vakte) për pjesëmarrësit (Anëtar jurie) e Olimpiadës Ballkanike të Matëmatikës për të rinjtë-Albania 2023 në datat 23.06.2023 deri më 28.06.2023”

NR.	Përshkrimi	Numri i pjesëmarrësve	Numri i ditëve	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	Fjetje në hotel	32	5		
2	Ushqimi në hotel (3 vakte)	32	5		
	Shuma pa TVSH				

Për lotin II ”Akomodim (fjetje dhe ushqim-3 vakte) për pjesëmarrësit (Nxënësit) e Olimpiadës Ballkanike të Matëmatikës për të rinjtë-Albania 2023 në datat 23.06.2023 deri më 28.06.2023”

NR.	Përshkrimi	Numri i pjesëmarrësve	Numri i ditëve	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	Fjetje në hotel	133	5		
2	Ushqimi në hotel (3 vakte)	133	5		
	Shuma pa TVSH				

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DEPOZITOJNË OPERATORËT PËR ZBATIMIN E SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME TO:

- Formulari i ofertës,
- Është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, se nuk ka proces penal, civil apo administrativ ndaj administratorit/pronarit të këtij objekti;
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë për nivelin e klasifikimit si strukturë akomoduese (për aktivitetin e Hotelarisë) të lëshuar nga Ministria e Turizmit.
- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitin financiar 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
 - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitet në distancë deri 20 km në vijë tokësore nga qendra e qytetit të Tiranës, dhe në lidhje me këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë pronësie (akt pronësie)/qeraje/huapërdorje të hotelit, i cili duhet të ndodhet në distancë deri 20 km në vijë tokësore nga qendra e qytetit të Tiranës.
 - Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar :

Për Lotin I: minimumi 5 (pesë) punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Për Lotin II: minimumi 8 (tetë) punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË HOTELET:

- Personat të cilët do të jenë, të ftuar nderi, lider dhe koordinator të JBMO 2023 gjatë procesit të Olimpiadës Ballkanike të Matematikës JBMO Albania 2023, janë nga të gjitha vëndet

pjesëmarrëse në këtë kompeticion, dhe numëri i tyre është konfirmuar për 32 (tridhjetë e dy) persona **ANËTARË JURIE**.

- Nxënësit pjesëmarrës së bashku me shoqëruesit në Olimpiadën e Matematikës JBMO Albania 2023 do të jetë e 133 (njëqind e tridhjetë e tre) persona **NXËNËS**.
- Akomodimi në hotel do të jetë për 5 (pesë) netë nga datat 23-28.06.2023.
- Pjesëmarrësit në olimpiadë **32 lidera** (anëtarë jurie), të ftuar nderi dhe koordinator të JBMO, do të duhet të akomodohen në dhoma dyshe, dhe hoteli duhet të ketë minimalisht 16 dhoma dhe akomodimi i tyre **DUHET DETYRIMISHT TË BËHET NË AMBIENTET E VETËM NJË HOTELI TË VETËM JO TË NDARË NË HOTELE TË NDRYSHME**.
- Akomodimi në hotel do të jetë për 5 (pesë) netë nga datat 23-28.06.2023.
- Akomodimi në dhoma hoteli dhe ushqimi për 133 (njëqind e tridhjetë e tre) nxënës dhe shoqërues dhe akomodimi me ushqimin për 32 (tridhjetë e dy) (anëtar jurie) të JBMO, nuk duhet të jenë në një objekt akomodues (**NUK DUHET TË JENË NË TË NJËJTIN HOTEL**) për arsye të procedurave që kanë të bëjnë me hartimin e testit etj, në funksion të zhvillimit të olimpiadës, pra nxënësit duhet të akomodohen në një hotel dhe anëtarët, të ftuar nderi dhe koordinator (anëtar jurie) në një hotel tjetër.
- Akomodimi për **133 nxënës** dhe shoqërues do të duhet të jetë në dhoma 3-4 persona dhe hoteli duhet të ketë minimalisht 35-45 dhoma, dhe akomodimi i tyre **DUHET DETYRIMISHT TË BËHET NË AMBIENTET E VETËM NJË HOTELI TË VETËM JO TË NDARË NË HOTELE TË NDRYSHME**.
- Subjekti duhet të garantojë ofrimin e shërbimit të ushqimit për 5 netë fjetjeje, të tre vaktet (mëngjes + drekë + darkë), në total 133 nxënës dhe shoqërues, për datat 23-28.06.2023.
- Subjekti duhet të garantojë ofrimin e shërbimit të ushqimit për 5 netë (fjetjeje), të tre vaktet (mëngjes + drekë + darkë) për 32 lider (anëtarë jurie) të ftuar nderi dhe koordinator të JBMO 2023, për datat 23-28.06.2023 dhe hoteli duhet të ketë minimumi 16 dhoma.
- Menuja duhet të përfshijë ushqime të shëndetshme, me të paktën 3 artikuj, nuk përmban pije alkoolike, si dhe plotëson specifika të ndryshme për një numër të kufizuar personash si: ushqime pa gluten, menu vegjetarian dhe vegan, kuzhinë hallall, sipas origjinës së përfaqësuesve dhe riteve të tyre fetare.
- Dhomat dyshe duhet të plotësojnë standartet sipas tipologjisë së dhomës.
- Për dhomat me min/max 3 deri në 4 persona duhet të plotësojnë standartet sipas tipologjisë së dhomës.
- Hotelet duhet të plotësojnë kushtet, duke u nisur nga ajo çka përfaqësojnë specifikisht pjesëmarrësit në olimpiadë dhe çfarë përfaqësojnë në botë personat e tjerë (lider, të ftuar nderi dhe koordinator të JBMO) në fushën e shkencës së Matematikës.
- Referuar veprimtarive dhe aktiviteteve të ndryshme të cilat do të zhvillohen në kuadër të Olimpiadës së Matematikës JBMO 2023 hotelet duhet të ndodhen në distancë deri 20 km në vijë tokësore nga qendra e qytetit të Tiranës, për shkak të veprimtarive të ndryshme që do të kryejnë këta persona në kryeqytet dhe afërsisë që duhet të kenë me mjedisin ku edhe do të

zhvillohen të gjitha etapat dhe fazat e kësaj olimpiade ballkanike, lehtësisë së transportit të tyre dhe kostos së transportit.

- Hotelet duhet të ofrojnë shërbime të tjera, për datat 23-28 Qershor 2023 si:
- ✓ Shërbim në dhomë.
 - ✓ Kanale Satelitore TV.
 - ✓ Shërbime për persona me AK.
 - ✓ Akses Interneti.
 - ✓ Credit Card.
 - ✓ Reception 24 H.
 - ✓ Shërbime lavanterie dhe pastrim dhome.
 - ✓ Ajer i klimatizuar i individualizuar.
 - ✓ Banjë ose vaskë.
 - ✓ Tavoline pune dhe karrige ergonomike.
 - ✓ Kasafortë në dhomë.
 - ✓ Thirrje telefonike direkte ndërkombëtare.
 - ✓ Rrymë elektrike 220 V/50 Hz dhe adaptore.

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

1. Hoteli i akomodimit të anëtarëve të jurisë 32 persona, duhet të ketë minimuni 16 dhoma dhe akomodimi i tyre duhet të bëhet vetëm në një ambient të vetëm në një hotel të vetëm.
2. Hoteli i akomodimit të nxënësve pjesëmarrës në olimpiadë 133 persona, duhet të ketë minimuni 35-45 dhoma dhe akomodimi i tyre duhet të bëhet vetëm në një ambient të vetëm në një hotel të vetëm.
3. Hotelet duhet të ndodhen në distancë deri 20 km në vijë tokësore nga qendra e qytetit të Tiranës.
4. Dhomat për anëtarët e jurisë dhe të nxënësve, duhet të plotësojnë standartet sipas tipologjisë së dhomës.
5. Subjekti duhet të garantojë ofrimin e shërbimit të ushqimit për 5 netë (fjetjeje), të tre vaktet (mëngjes + drekë + darkë) për 32 lider (anëtarë jurie) për datat 23-28.06.2023.
6. Subjekti duhet të garantojë ofrimin e shërbimit të ushqimit për 5 netë (fjetjeje), të tre vaktet (mëngjes + drekë + darkë) për 133 (nxënës pjesëmarrës) për datat 23-28.06.2023.
7. Menuja duhet të përfshijë ushqime të shëndetshme, me të paktën 3 artikuj, nuk përmban pije alkoolike, si dhe plotëson specifika të ndryshme për një numër të kufizuar personash si: ushqime pa gluten, menu vegjetarian dhe vegan, kuzhinë hallall, sipas origjinës së përfaqësuesve dhe rriteve të tyre fetare.

Shënim: Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në formën e tij ligjore (i njehsuar me origjinalin) dhe i lëshuar brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ofertës.

Ofertat, e shoqëruara me dokumentacionin përkatës sipas kritereve të përcaktuara më sipër, duhet të paraqiten deri në datën 19.06.2022, ora 10.00, në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, në zarf të mbyllur.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLA

